

RELACION
PËR PROJEKT-URDHRIN
“PËR NGRITJEN E TASK - FORCËS NDËRINSTITUCIONALE PËR
MENAXHIMIN E SEZONIT TURISTIK VEROR 2023”

I. QËLLIMI I PROJEKT-URDHRIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projekt-urdhri, që vjen si propozim i Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, është ngritja e Task - Forcës Ndërinstitucionale të sezonit turistik veror 2023, e cila asiston Komitetin për Menaxhimin e Sezonit Turistik (KMST) dhe është përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin në afat të masave përgatitore të përcaktuara në planin e masave, miratimi i planit të masave për sezonin turistik veror 2023.

Në vijim të problematikave të hasura gjatë sezonit turistik veror 2022, lind e nevojshme që edhe për vitin 2023 të ndiqet e njëjta procedurë për menaxhimin e sezonit turistik.

II. VLERËSIMI I PROJEKT-URDHRIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij projekt-urdhri nuk është parashikuar në programin analitik të akteve të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, por është në përputhje me Programin Politik të Këshillit të Ministrave dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019 – 2023.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKT-URDHRIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Nëpërmjet ngritjes së Task-forcës synohet:

- Koordinimi në nivel specialistësh për shkëmbimin e shpejt të informacionit nëpërmjet institucioneve të përfshira duke krijuar regjistra të mirëfilltë turistikë me informacion të gjerë përsa i përket subjekteve si: kapaciteti akomodues, numri i shtretërve, numri i punonjësve, numri i çadrave nëse disponojnë stacion plazhi, pagat, përgjegjësia tatimore, qarkullimi, çmimet për dhomë, kategorizimi i strukturës, adresa e saktë, etj.

- Pajisja e stacioneve të plazhit me lejet përkatëse dhe lidhja e kontratave respektive me bashkinë përpara fillimit të sezonit turistik.
- Inspektime të përbashkëta në mënyrë që mos të ketë prezencë të shtuar në subjekte në lidhje me problematika të ndryshme.
- Koordinimi ndërinstytucional për mbarëvajtje dhe menaxhim sa më të mirë të sezonit turistik veror 2023.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projekt-urdhri është hartuar në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 64, të ligjit nr.93/2015 “Për Turizmin”, i ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE*

Ky projekt-urdhër nuk ka për qëllim përafrimin e legjislacionit me *Acquis Communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKT-URDHRIT:

Projekt-urdhri për ngritjen e Task-Forcës ndërinstytucionale të sezonit turistik veror parashikon si më poshtë:

Ngritja e Task-Forcës ka për synim asistimin që do t'i bëhet Komitetit për Menaxhimin e Sezonit Turistik (KMST) dhe njëkohësisht do të jetë përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin në afat të masave përgatitore të përcaktuara në planin e masave për sezonin turistik veror. Task-Forca do të asistohet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe në përbërje do të ketë përfaqësi nga institucionet qendrore si Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Kulturës, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Njësitë e Vetqeverisjes Vendore, Prefekturat, agjenci dhe drejtori të përgjithshme në varësi të institucioneve të sipërpërmendura.

Task-Forca për sezonin turistik veror 2023 do të ketë disa detyra kryesore:

- Të udhëzojë përgatitjen dhe të miratojë tërësinë e veprimtarive që do të kryejë çdo institucion/agjenci zbatuese, në zbatim të planit të masave për sezonin turistik;

- Të bashkërendojë veprimtaritë ndërmjet institucioneve zbatuese. Të analizojë në vijimësi zbatimin e masave për çdo institucion;
- Të propozojë, nëse është e nevojshme, nxjerrjen e akteve nënligjore, që i shërbejnë zbatimit të masave përgatitore, sipas planit të masave;

Të ngarkojë me detyra drejtuesit dhe strukturat zbatuese të drejtpërdrejta, të veprimtarive të planifikuara në planin e masave për sezonin turistik. Në lidhje me organizmin e mbledhjeve, Task-Forca do të mbledhet të paktën, 2 (dy) herë në muaj dhe çdo përfaqësues do të raportojë mbi ecurinë e veprimtarive për institucionin/agjencinë zbatuese që përfaqëson. Ndërsa Ministri i Turizmit dhe Mjedisit do t'i raportojë Kryeministrit për rezultatet e arritura dhe për çështje të rëndësishme që kërkojnë zgjidhje të menjëhershme.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E URDHRI

Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Kulturës, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Inspektoriatit Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Task-Forca e Transportit Rrugor, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Qendra Kombëtare Urgjencës Mjekësore, Agjencia Kombëtare e Turizmit, për zbatimin e këtij urdhri.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT-URDHRI

Për hartimin e këtij projekt-urdhri kanë kontribuar Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator dhe Drejtoria e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve në Turizëm.

Plani i masave është dërguar për mendim pranë: Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Kulturës, Autoritetit Rrugor Shqiptar, Policisë së Shtetit, Inspektoriatit Shtetëror

Shëndetësor, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, Agjencisë Kombëtare të Turizmit dhe Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Taskë-Forcës së Transportit Rrugor, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Task-Forcës së Transportit Rrugor.

Institucionet që kanë dhënë dakordësinë, duke konfirmuar draftin e planit të masave janë:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore;
- Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile;
- Autoriteti Rrugor Shqiptar;
- Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit;
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
- Agjencia Kombëtare e Turizmit;
- Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit;
- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit;
- Task - Forca e Transportit Rrugor;
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka dhënë dakordësinë duke sugjeruar masa shtesë si më poshtë vijon:

- Kontrolli i subjekteve tregtare për zbatimin e procedurës së fiskalizimit;
- Kontrolli i subjekteve tregtare në destinacionet turistike për lëshimin e faturës tatimore;
- Kontrolli i tatimpaguesve nëse janë rregjistruar në përgjegjësitë përkatëse tatimore;
- Monitorimi i afishimit të çmimeve pranë çdo subjekti tregtar;
- Verifikimi i deklarimit të punonjësve dhe pagave në organin tatimor.

Në mënyrë që të zhvillohet sa më mirë puna e Task – Forcës Ndërinstitucionale kanë propozuar që Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ti vendoset në dispozicion, në fillim të sezonit turistik, lista e strukturave të certifikuara akomoduese dhe kontratave të lidhura për stacionet e plazhit.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kanë konfirmuar dakordësinë me rubrikat e vendosura për MSHMS vetëm me disa ndryshime si më poshtë:
Në masën: *Të hartohen dhe miratohen me Vendim të Këshillit Bashkiak nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, planet lokale të zhurmave.*

Të zbatohet programi i kontrollit, për monitorimin e ndotjes akustike në destinacionet turistike.

INSTITUCIONET BASHKËPUNUESE:

Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore

Prefektura

Policia e Shtetit,

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor

Në lidhje me këtë pikë, MSHMS ka informuar se: Inspektorati Shtetëror Shëndetësor nuk kryen matjet e ndotjes akustike/ ajrit, nuk disponon aparatura dhe rrjedhimisht nuk mund të ketë tagrin për vendosjen e masave administrative ndaj subjekteve që mund të shkelin standartet. NE BAZE TE VKM 587 datë 07.07.2010 “Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike” neni 5 citohet “Strukturat vendore të Policisë së Shtetit dhe strukturat ekzekutive të Njësisë të Qeverisjes Vendore ndjekin zbatimin e vendimit të marrë nga ana e Inspektoriatit të Mjedisit pa praninë e tyre, në subjektet që gjenerojnë zhurmë në kundërshtim me ligjin. Vendimet e marra të Inspektoriatit të Mjedisit i komunikohen këtyre strukturave me shkresë zyrtare”. Sa me sipër ndjekja e kësaj pike duhet të kryhet nga Inspektorati i Mjedisit në bashkëpunim me Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor.

Gjithashtu MSHMS ka shtuar disa masa si më poshtë, të cilat kanë propozuar të ndiqen nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore:

- Organizimi i shërbimit shëndetësor në qendrat shëndetësore që do të funksionojnë pranë zonave turistike të vendit gjatë sezonit veror. (identifikimi i strukturave që do të shërbejnë si qendra shëndetësore verore, vendosja e sinjalistikës, paisja e tyre me paisjet e nevojshme;
- Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor sipas një liste të përcaktuar shërbimesh për qytetarët që paraqiten pranë këtyre qendrave;
- Trajnimi i stafëve mjekësore që do të ofrojnë shërbim shëndetësor në qendrat shëndetësore që do të funksionojnë pranë zonave turistike të vendit gjatë sezonit veror.

Ministria e Kulturës ka konfirmuar planin e masave si edhe ka bërë me dije mbi masat të tjera të cilat do të jenë në detyrat e MK për sezonin turistik 2023.

- Ngritja e Task Forceës së MK dhe detyrat përkatëse në realizimin e këtij procesi;
- Hartimin e kalendarit të aktiviteteve kulturore pjesëe kalendarit të projekteve kulturore të mbështetura nga MK për vitin 2023 (me thirje dhe jo vetëm);
- Kalendarin e aktiviteteve "Javët Kulturore Ndërkombëtare".

Udhëzimin e Ministrit të Kulturës lidhur me menyrën e funksionimit dhe përgjegjësitë e institucioneve të trashëgimisë kulturore dhe muzeve gjatë sezonit turistik i cili parashikon masat për:

- Zgjatjen e orareve të funksionimit të institucioneve dheapja për publikun çdo dite të javës;
- Pajisja me bileta elektronike; online dhe manuale përkundrejt çdo vizitori;
- Pajisjen me faturën tatimore për Agjencitë Turistike dhe jo vetëm përkundrejt shërbimit të kërkuar;
- Pajisja me uniforma me logon e MK dhe institucionit përfaqësues;
- Marrja e masave për prezantimin online në faqet zyrtare; web dhe rjetet sociale të gjithë veprimtarisë dhe aktivisteve kulturore përgjatë sezonit tek institucionet kulturore;
- Paraqitja e kalendarit të aktiviteteve në nivel kombëtar në faqen zyrtare të MK dhe institucioneve ku do të zhvillohen;
- Ngritjen e stukturave të monitorimit përgjatë sezonit;
- Raportimin në kohë reale të çdo problematike të hasur gjatë orarit të funksionimit;
Koordinimin me cicërohet dhe udhëdëftuesit turistik ku ato janë të certifikuar dhe ku grupet e turistëve e kërkojnë këtë shërbim nga institucionet e trashëgimisë dhe muzeve;
- Publikimin në faqen zyrtare të MK të këtij kalendarit.

Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka dërguar detyrat kryesore për zbatim nga AKB dhe Agjencitë Rajonale të Bregdetit Lezhë, Durrës, Vlorë, Sarandë, janë të fokusuara si më poshtë vijon:

- Përgatitja e kontratave për përdorimin e hapësirës së plazhit, për subjektet aplikues për sezonin turistik veror 2023, pas miratimit të tyre nga Grupi

Teknik i Shqyrtimit të Aplikimeve, me palë përfituese Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

- Ndjekja e procesit të pastrimit të zonës bregdetare nga operatori ekonomik i kontraktuar për realizimin e këtij shërbimi, për periudhën 15 Qershor -15 Shtator 2022, për Bashkitë Durrës, Kavajë, Himarë, Sarandë, Rrogozhinë, Vlorë, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 891, datë 27.12.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 569, datë 17.07.2019 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”, i ndryshuar.
- Takime me njësitë vendore, prefekturat dhe institucionet kompetente për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 171, datë 27.03.2019 *Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”*, i ndryshuar, si dhe diskutimin e planit të masave për mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2023.
- Ushtrimi i kontrollit dhe inspektimit në të gjitha stacionet e plazhit në vijën bregdetare, për përmbushjen e kriterëve dhe standarteve në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 171, datë 27.03.2019 *Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”*, i ndryshuar, si dhe inspektimi i të gjitha veprimtarive turistike në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 93/2015 *“Për Turizmin”*, i ndryshuar.
- Monitorimi i zhvillimeve dhe ndërhyrjeve në zonën bregdetare, si dhe bashkëpunimi me institucionet kompetente që operojnë në zonën bregdetare dhe në zonat ku ushtrohen veprimtari turistike, në bashkëpunim me Agjencitë Rajonale të Bregdetit Lezhë, Durrës, Vlorë, Sarandë.
- Raportime pranë institucioneve kompetente për të gjitha shkeljet që do të evidentohen në terren, përgjatë monitorimeve të përditshme, me qëllim marrjen e masave për parandalimin e tyre.
- Monitorimi i parcelave të përcaktuara si plazhe publike, kriterëve dhe standarteve në këto plazhe, sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 171, datë 27.03.2019 *Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”*, i ndryshuar .
- Realizimi i detyrave funksionale në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 569, datë 17.07.2019 *“Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit*, i

ndryshuar, planeve të miratuara, si dhe detyrave të tjera të ngarkuara me akte ligjore apo nënligjore.

- Ndjekja e procesit të aplikimeve për stacione sezonale ancorimi/bregëzimi, sipas parashikimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 29.4.2022 “Për kriteret e vendosjes dhe të funksionimit të stacioneve sezonale të ancorimit/bregëzimit”.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura ka raportuar se prioriteti i (AKZM) është “përcaktimi i pikave turistike që mund të ndoten me mbetje gjatë sezonit turistik 2023, grumbullimi dhe largimi i tyre në vendet e përcaktuara nga bashkitë, dhe veçanërisht në zonat bregdetare dhe brigjet e liqenit”.

Administratat e Zonave të Mbrojtura, veçanërisht ato të vijës bregdetare dhe bregliqenore (Shkodër, Lezhë, Durrës, Fier, Vlorë dhe Korçë) tashmë i kanë përcaktuar dhe identifikuar venddepozitimet për të gjitha pikat ku mund të grumbullohen mbetje dhe në bashkëpunim me strukturat e institucioneve të pushtetit vendor dhe drejtoritë arsimore (shkollat 9-vjeçare dhe të mesme), do të realizojnë pastrimin e mbetjeve sipas pikave të identifikuara dhe largimin e më pas depozitim të tyre në pikat e caktuara nga bashkia.

Organizimi i punës për pastrimin e mbetjeve do të ndiqet drejtpërdrejtë nga Administrata e zonës së mbrojtur dhe do të raportohet mbi realizimin e saj pranë AKZM-së dhe Prefektit.

Përveç objektivit kryesor të përcaktuar Në Planin e Masave për sezonin 2022, AKZM/ADZM synojnë ndër të tjera dhe realizimin e objektivave që do të integrohen në Planin e Masave për sezonin turistik 2023 si më poshtë:

- Konservimi dhe mbrojtja e burimeve natyrore në territorin e zonave të mbrojtura, ku ekosistemet do të ofrojnë shërbimet e tyre për vizitorët;
- Monitorimi i mbarëvajtjes së sezonit turistik për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi dhe të strukturave të shërbimit;
- Vënien në rolin e guidës së stafit të zonave të mbrojtura në shtigjet e markuara;
- Funksionimin e qendrave ekzistuese të informacionit të mëposhtëm, përmes bashkërendimit të punës me pushtetin vendor. Menaxhimi i vizitorëve në çdo stinë të vitit dhe ofrimi i informacionit të nevojshëm përmes hartave, fletëpalosjeve, etj.;
- Informim dhe promovim nëpërmjet faqes web AKZM.gov.al.

IX.

RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i projekt-urdhrit nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

MINISTRI I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO FURXHI

